TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

**FAKULTETI I DREJTËSISË**

# RREGULLORE E PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË NË "DREJTËSI"

**(300 ECTS)**

## KREU I
## PARIMET E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Baza ligjore

Rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi" mbështetet në Ligjin Nr. 80, 22. 07. 2015 "*Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Strategjinë e Zhvillimit të TBU-së, Statutin dhe Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor të Kolegjit Universitar "Tirana Business University".

### Neni 2
### Objekti

Kjo rregullore përcakton organizimin e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi" me 300 ECTS. Ajo është hartuar në përputhje me, legjislacionin në fuqi, duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.
Çdo aspekt tjetër që nuk është trajtuar në këtë rregullore do të trajtohet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor dhe Statutin e TBU-së.

## KREU II
## ELEMENTËT E PROGRAMIT MËSIMOR

### Neni 3
### Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij programi studimi është të përgatisë juristë, të cilët janë specialistë për çështje juridike, të aftë për të punuar në shoqëri tregtare publike dhe/ose private, por edhe në studio të ndryshme avokatie që i shërbejnë biznesit.

Objektivat e programit janë:

- Studenti të pajiset me njohuritë themelore dhe të avancuara të shkencës juridike, dhe të mund të përvetësojë më në gjerësi dhe thellësi njohuritë në fushën e së drejtës e harmonizuar me të drejtën civile, penale, administrative dhe tregtare. Njohuritë e fituara nga studenti përfaqësojnë eksperiencat e konsoliduara të fushës dhe të përshtatura edhe për kushtet e ekonomisë shqiptare.

- Të pajisë studentin me njohuri të avancuara mbi legjislacionin shqiptar por edhe me njohuritë e nevojshme nga legjislacioni europian për çështjet juridike.

- Studenti të jetë i aftë të zgjidhë probleme praktike e komplekse që hasin shoqëritë tregtare dhe studiot ligjore, si dhe institucionet publike, gjatë viteve të studimit nëpërmjet kryerjes së praktikave në to dhe/ose punësimit.

- Studenti të jetë kompetent e të marrë përsipër përgjegjësi për të zgjidhur situata të paparashikuara në punë si në sektorin publik, por mbi të gjitha në atë privat, ku njohuritë e fituara lejojnë që ai të përshtatet lehtë në ambjentet e biznesit.

- TBU synon që përpara mbarimit të vitit të pestë të studimeve, studentët më cilësorë të jenë punësuar në pozicion pune ndihmës jurist në zyra juridike ose në pozicione pune në banka, kompani apo zyra publike ku trajtohen çështje juridike.

## Neni 4
## Programi i Studimit

a) Programi i integruar i ciklit të dytë në "Drejtësi" ka një kohëzgjatje normale 5 vjeçare, të cilit i përkon 300 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë.

b) Programi mësimor është parashikuar të realizohet në të paktën 7500 orë, nga të cilat 2625 orë janë orë studimi në auditor dhe 4875 janë orë studimi individual.

c) Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti kryen praktikë profesionale ose punë në profilin e tij të studimeve me jo më pak se 5 javë.

d) Koha e fillimit, mbarimit, sezonit të provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga senati akademik në fillim të çdo viti akademik.

## Neni 5
## Struktura e programit të studimit

Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 5 kategori sipas Tabelës nr.1.

*Tabela nr. 1: Struktura e programit*

| Katego-ria | Tipi i veprimtarisë dhe kategoria përkatëse | Nr. | Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera | Kreditet e lendeve | Kodi i lendes |
|---|---|---|---|---|---|
| A | Lëndë Bazë *(Kategoria A) 15%-20% (ECTS)* | 1 | E Drejtë Romake | 6 | DRA01 |
| | | 2 | Komunikim Profesional dhe Akademik | 10 | BUS 245 |
| | | 3 | E Drejtë Publike | 8 | DRA03 |
| | | 4 | Hyrje në Ekonomi | 6 | DRA04 |
| | | 5 | Filozofi e së Drejtës | 7 | DRA05 |
| | | 6 | E Drejtë Kushtetuese | 12 | DRA06 |
| | | 7 | Histori e Shtetit dhe të Drejtës në Shqipëri | 6 | DRA07 |
| | | 8 | Përgjegjësia Civile dhe Penale e Biznesit | 5 | DRA08 |
| | | 9 | Të Drejtat e Njeriut | 6 | DRA09 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 10 | E Drejtë Private | 6 | DRA10 |
| | | | **Kreditet per tu plotesuar nga studenti ne kete kategori jane 45 deri ne 60 ECTS** | **84** | |
| B | **Lëndë Karakterizuese** *(Kategoria B) 45%-55% (ECTS)* | 1 | E Drejtë Civile I | 6 | DRB01 |
| | | 2 | E Drejtë Penale (pj e përgjithshme) | 6 | DRB02 |
| | | 3 | E Drejtë Ndërkombëtare Publike | 10 | DRB03 |
| | | 4 | E Drejtë Administrative | 6 | DRB04 |
| | | 5 | E Drejtë e Detyrimeve dhe Kontratave | 12 | DRB05 |
| | | 6 | E Drejtë Penale (pj e posaçme) | 12 | DRB06 |
| | | 7 | Procedurë Civile | 18 | DRB07 |
| | | 8 | E Drejtë e Punës | 10 | DRB08 |
| | | 9 | E Drejtë Familjare | 7 | DRB09 |
| | | 10 | Procedurë Penale | 12 | DRB10 |
| | | 11 | E Drejtë e Shoqërive Tregtare | 10 | DRB11 |
| | | 12 | Metodat e Kërkimit | 10 | DRB12 |
| | | 13 | E Drejtë Europiane | 12 | DRB13 |
| | | 14 | Procedure Administrative | 6 | DRB14 |
| | | 15 | E Drejte Civile II | 6 | DRB15 |
| | | 16 | E Drejtë e Pronesise Intelektuale | 6 | DRB16 |
| | | 17 | E Drejtë Ndërkombëtare Private | 10 | DRB17 |
| | | 18 | E Drejtë Biznesi | 6 | DRB18 |
| | | 19 | E Drejtë Bankare dhe Financiare | 6 | DRB19 |
| | | 20 | E Drejtë Europiane Private | 6 | DRB20 |
| | | 21 | E Drejtë e Falimentit | 6 | DRB21 |
| | | 22 | E Drejtë Tregtare Europiane | 6 | DRB22 |
| | | 23 | E Drejtë Administrative Europiane | 6 | DRB23 |
| | | 24 | Anglishtja Profesionale | 5 | BUS 125 |
| | | | **Kreditet per tu plotesuar nga studenti ne kete kategori jane 135 deri ne 165 ECTS** | **189** | |
| C | **Lëndë Ndërdisiplinore/ Integruese** *(Kategoria C)* *12%-15% (ECTS)* | 1 | Gjykimi Administrativ | 6 | DRC01 |
| | | 2 | E Drejte e Konkurrencës dhe Antitrust | 6 | DRC02 |
| | | 3 | Alternativa e Zgjidhjes së Mosmarreveshjes | 5 | DRC03 |
| | | 4 | Mjedisi Rregullator i Biznesit | 6 | DRC04 |
| | | 5 | Hyrje në Biznes | 5 | BUS 125 |
| | | 6 | E Drejtë Konsumatorit dhe Siguria Produkteve | 5 | DRC06 |
| | | 7 | Avokatia Praktike e Biznesit | 6 | DRC07 |
| | | | **Lëndë me zgjedhje** | | |
| | | 8 | E Drejtë Fiskale | 6 | DRC08 |
| | | 9 | Kontabilitet financiar për juristët | 6 | DRC09 |
| | | 10 | Sjellje Organizative dhe Lidership | 6 | MBA 114 |
| | | 11 | Siguria në Biznesi dhe Shërbimet e Sigurisë | 6 | DRC11 |
| | | 12 | Qeverisje e Koorporatave | 6 | MBA 120 |
| | | | **Kreditet per tu plotesuar nga studenti ne kete kategori jane 36 deri ne 45 ECTS** | **81** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| D | **Lëndë Plotësuese** *(Kategoria D) 6%-8% (ECTS)* | 1 | Anglishtja Profesionale | 5 | BUS 115 |
| | | 2 | Hyrje në informatike | 5 | BUS 124 |
| | | 3 | Hyrje në Logjikën Formale Klasike | 6 | DRD03 |
| | | 4 | Shkrim dhe Hartim i Kontratave | 5 | DRD04 |
| | | 5 | Praktikë Profesionale | 15 | DRD05 |
| | | | **Kreditet per tu plotesuar nga studenti ne kete kategori jane 18 deri ne 24 ECTS** | **35** | |
| E | **Detyrime Përmbyllëse** *(Simboli E) 3%-5% (ECTS)* | 1 | Temë Diplomë / Provim i Përgjithshëm Përfundimtar | 15 | DRE01 |
| | | | **Kreditet per tu plotesuar nga studenti ne kete kategori 15 ECTS** | **15** | |
| | | | **Kreditet minimale per tu plotesuar nga studenti 300 ECTS** | | |
| | | | | | |

## Neni 6
## Plani mësimor

Plani mësimor indikativ pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës disiplinë dhe veprimtari formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale të ndara në semestra, është dhënë në Aneksin A.

## Neni 7
## Fleksibiliteti i Strukturës dhe planeve mësimore

Në planin mesimor çdo vit akademik do të përcaktohen nga Dekanati lëndët konkrete, të papërmendura me emër të përveçëm në Aneksin A, që do të zhvillohen për kategoritë A, B dhe D të veprimtarive formuese brenda intervaleve minimale dhe maksimale të krediteve që duhen plotësuar për secilën kategori.

Në kategorinë e veprimtarisë formuese C, para lëndëve me zgjedhje, Dekanati përcakton të paktën 3 lendë që do të zhvillohen në vitin akademik të dhënë, ndërsa tek lëndët me zgjedhje, studenti mund të zgjedhë deri në 4 lëndë prej tyre. Gjithashtu, këto plane mësimore përshtaten edhe në përputhje me nenet 6,7, 12 dhe 32 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.

## Neni 9
## Praktikat mësimore

Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit praktik bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor dhe Rregulloren për Praktikën Mësimore.

## Neni 10
## Kontrolli i dijes dhe sistemi i vlerësimit

Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor janë të përcaktuara me detaje në nenet 14-23 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.
Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë me numër. Nota me gërma përdoret për lehtësi konvertimi me sistemet e përdorura ndërkombëtarisht.

Lidhja e sistemit me notë dhe me pikë në lëndët e programit të integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi" jepet nga tabela më poshtë:

| **Pikë** | ≤ 49 | 50 – 55 | 56 – 60 | 61 – 70 | 71 – 80 | 81 – 90 | 91 – 100 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nota** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| **Gërma** | F | D | C | C+ | B | B+ | A |

**Neni 11**
**Diplomimi**

Studentët në programin e integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me temë diplome.
Kriteret e notës mesatare do të përcaktohen çdo vit nga Dekanati.

## KREU III
## PRANIMI I STUDENTËVE DHE AFATET E STUDIMIT

**Neni 12**
**Kriteret dhe Procedura e Pranimit të Studentëve**

a) Programi i studimeve është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë të paktën një diplomë të shkollës së mesme, shqiptar ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentet me transferim.
b) Kriteret e pranimit përcaktohen nga rezultatet e studentëve nga shkolla e mesme dhe nga intervista që do të kryhet nga Njësitë Bazë përgjegjëse. Për renditjen përfundimtare të studenteve që do të pranohen:
c) Përpara fillimit të rregjistrimeve të çdo viti akademik Njësitë Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit mund të ndryshojnë kriteret e veçanta të cilat miratohen nga Rektori i TBU.

**Neni 13**
**Afati i studimeve**

a) Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi" është 5 vite akademikë (10 semestra).
b) Studenti mund të vijojë pjesëmarrjen në programin e mësipërm edhe mbi kohën normale të studimeve. Në këtë rast ai duhet të shlyejë detyrimet sipas planit mësimor dhe paguajë tarifat përkatëse.

## KREU IV
## VLERËSIMI ME KREDITE

**Neni 14**

## KREU IV
## VLERËSIMI ME KREDITE

### Neni 14
### Krediti dhe llogaritja e tij

Kreditet për çdo modul përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara nga programi.

| 1 kredit (ECTS) = 25 orë punë në total |
|---|
| Orë në auditor 1 ECTS = 10 orë<br>Orë punë individuale = 15 orë<br>(Detyra shtëpie, Punë në grup, Provime të pjesshën Provimi final) |

## KREU V
## VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT

### Neni 15
### Sigurimi i brendshëm i cilësisë

a) Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programin e integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi" vlerësohen çdo vit në përfundim të programit, sipas modaliteteve që përcaktohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
b) Vlerësimi shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij në vite.
c) Grupi i vlerësimit të brendshëm në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbledh të gjithë informacionin për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.

## KREU VI
## DISPOZITA TE FUNDIT

### Neni 16
### Ndryshimi i kësaj rregulloreje

a) Kjo rregullore mund të përsoset e korrigjohet në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër programi i integruar të ciklit të ulët të dytë në "Drejtësi".
b) Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit të Drejtësisë.

Miratuar
*Senati Akademik nr. 5, date 04.11.2019*

Rektor
*Prof. Dr. Ilia Kristo*

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

*Aneks A : Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi*

**Miratoi**

**Dekani** — *Prof. Asoc. Endri Papajorgji*

**Rektori** — *Prof. Dr. Ilia Kristo*

**PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TE INTEGRUAR TE CIKLIT TE DYTE NE "DREJTESI"**

| SEMESTRI | Nr. | Lendet | Kategoria e vep.formue se | ECTS | Leksione | Seminare | Jave gjithsej | Gjithsej Leksione | Gjithsej Seminare | Total ore ne auditor | Ore pune individuale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SEMESTRI I | 1 | E DREJTE ROMAKE | A | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 2 | LENDE BAZE Nr.1 ** | A | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 3 | E DREJTE PUBLIKE* | A | 4 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 55 |
| | | E DREJTE KUSHTETUESE* | A | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 5 | HISTORIA E SHTETIT DHE E SE DREJTES NE SHQIPERI | A | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| **Total semestri I** | | | | **28** | **13** | **6** | 15 | **195** | **90** | **285** | **415** |
| SEMESTRI II | 6 | E DREJTE PUBLIKE* | A | 4 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 55 |
| | 7 | E DREJTE KUSHTETUESE* | A | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 8 | LENDE ME ZGJEDHJE Nr.2 | C | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 9 | KOMUNIKIM PROFESIONAL DHE AKADEMIK | A | 10 | 3 | 3 | 15 | 45 | 45 | 90 | 160 |
| | 10 | FILOZOFIA E SE DREJTES | A | 7 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 115 |
| **Total Semestri II** | | | | **32** | **13** | **7** | **15** | **195** | **105** | **300** | **500** |
| **Total Viti I** | | | | **60** | **26** | **13** | **30** | **390** | **195** | **585** | **915** |
| SEMESTRI | 1 | ANGLISHTJA PROFESIONALE | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III | 2 | E DREJTE CIVILE I | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 3 | E DREJTE PENALE E PERGJITHSHME | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 4 | E DREJTE NDERKOMBETARE PUBLIKE* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 5 | E DREJTE ADMINISTRATIVE | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 6 | METODAT E KERKIMIT* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | | **Total semestri III** | | **33** | **15** | **6** | **15** | **225** | **90** | **315** | **510** |
| SEMESTRI IV | 7 | E DREJTE CIVILE II | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 8 | E DREJTE NDERKOMBETARE PUBLIKE* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 9 | PROCEDURE ADMINISTRATIVE | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 10 | METODAT E KERKIMIT* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 11 | LENDE NDERDISIPLINORE Nr.1** | C | 5 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 65 |
| | | **Total semestri IV** | | **27** | **12** | **6** | **15** | **180** | **90** | **270** | **405** |
| | | **Total Viti II** | | **60** | **27** | **12** | **30** | **405** | **180** | **585** | **915** |
| SEMESTRI V | 1 | E DREJTE E DETYRIMEVE DHE KONTRATAVE* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 2 | E DREJTE PENALE E POSACME* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 3 | E DREJTE EUROPIANE* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 4 | E DREJTA E PUNES* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 5 | E DREJTE E SHOQERIVE TREGTARE* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | | **Total semestri V** | | **28** | **13** | **5** | **15** | **195** | **75** | **270** | **430** |
| SEMESTRI VI | 6 | E DREJTE E DETYRIMEVE DHE KONTRATAVE* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 7 | E DREJTE PENALE E POSACME* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 8 | E DREJTE EUROPIANE* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 9 | E DREJTE E PUNES* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 10 | E DREJTE E SHOQERIVE TREGTARE* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 11 | PRAKTIKA PROFESIONALE | D | 4 | | | | | | | 100 |
| | | **Total Semestri VI** | | **32** | **13** | **5** | **15** | **195** | **75** | **270** | **530** |
| | | **Total Viti III** | | **60** | **26** | **10** | **30** | **390** | **150** | **540** | **960** |
| SEMESTRI VII | 1 | LENDE KARAKTERIZUESE Nr.1 ** | B | 7 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 115 |
| | 2 | LENDE ME ZGJEDHJE Nr.1 | C | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 3 | PROCEDURE PENALE* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 4 | PROCEDURE CIVILE* | B | 9 | 4 | 2 | 15 | 60 | 30 | 90 | 135 |
| | | **Total semestri VII** | | **28** | **13** | **5** | **15** | **195** | **75** | **270** | **430** |
| SEMESTRI VIII | 6 | LENDE BAZE Nr.2 ** | A | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 7 | PROCEDURE PENALE* | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 8 | PROCEDURE CIVILE* | B | 9 | 4 | 2 | 15 | 60 | 30 | 90 | 135 |
| | 9 | GJYKIMI ADMINISTRATIV | C | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 10 | PRAKTIKA PROFESIONALE | D | 5 | | | | | | | 125 |
| | | **Total semestri VIII** | | **32** | **13** | **5** | **15** | **195** | **75** | **270** | **530** |
| | | **Total Viti IV** | | **60** | **26** | **10** | **30** | **390** | **150** | **540** | **960** |
| SEMESTRI IX | 1 | E DREJTE NDERKOMBETARE PRIVATE* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 3 | LENDE ME ZGJEDHJE Nr.3 | C | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 4 | LENDE ME ZGJEDHJE Nr.4 | C | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 5 | E DREJTE E PRONESISE INTELEKTUALE | B | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Total semestri IX | | | | 23 | 11 | 4 | 15 | 165 | 60 | 225 | 350 |
| SEMESTRI X | 6 | LENDE PLOTESUESE NR.1 ** | D | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 7 | LENDE NDERDISIPLINORE Nr.2 ** | C | 6 | 3 | 1 | 15 | 45 | 15 | 60 | 90 |
| | 8 | E DREJTE NDERKOMBETARE PRIVATE* | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 9 | PRAKTIKA PROFESIONALE | D | 6 | | | | | | | 150 |
| | 10 | TEME DIPLOME / PROVIM I PERGJITHSHEM PERFUNDIMTAR | E | 15 | | | | | | | 375 |
| Total semestri X | | | | 37 | 7 | 3 | 15 | 105 | 45 | 150 | 775 |
| Total Viti V | | | | 60 | 18 | 7 | 30 | 270 | 105 | 375 | 1125 |
| | | | | | | | | | | | |
| TOTAL Programi i integruar ne ciklin e dyte ne "Drejtesi" | | | | 300 | 123 | 52 | 150 | 1845 | 780 | 2625 | 4875 |

***Shënim:*** * Lëndë vjetore dhe zhvillohen në semestër të parë dhe të dytë.

** Lëndë konkrete, të cilat do të përcaktohen çdo vit nga Dekanati